

# Situata e Komunitetit LGBTI+ gjatë pandemisë Covid -19

Aleanca LGBTI



**PËRGATITI:**  
**XHENI KARAJ**  
**LIVIA ZOTRIJA**  
**ANXHELA IBRAHIMLLARI**  
**IRDI ISMAILI**  
**VITORI ÇIPI**

## Situata e Komunitetit LGBTI+ gjatë pandemisë Covid -19

Ky studim, që synon të identifikojë pasojat e pandemisë së Covid-19 mes komunitetit LGBTI, i realizuar nga Aleanca LGBTI, është zhvilluar online përmes një sondazhi të plotësuar nga **228** individë të vetëidentifikuar si pjesëtarë të komunitetit LGBTI, si dhe përmes realizimit të fokus-grupeve. Ky kampion e bën këtë studim më të madhin që është zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri për komunitetin LGBTI.

Pyetëtori u publikua në rrjetet sociale gjatë muajit qershor. Përgjigjet përfshijnë dëshmi mbi pasojat që pandemia ka pasur tek personat LGBTI duke nisur nga muaji mars, kur u shpall dhe gjëndja e jashtëzakonshme në nivel kombëtar. Pyetëtori shqyrton fusha jetike si ekonomia, punësimi, strehimi dhe siguria, si dhe mundësia e komunitetit LGBTI për të plotësuar nevojat bazike gjatë pandemisë.

**Rezulton se 47 përqind e komunitetit LGBTI ishin të papunë.** Kjo shifër është dukshëm më e lartë se shifra e një studimi paraprak të Bankës Botërore që konfirmoi se **38 përqind e shqiptarëve kanë humbur punën gjatë pandemisë.** Një ndër arsyt kryesore pse shifra e papunësisë mes komunitetit LGBTI është më e lartë se shifra e papunësisë së popullsisë së gjerë në Shqipëri, ka të bëjë me faktin se komuniteti LGBTI vuante nga numri i lartë i papunësisë sistematike që përpara shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme. Ndonëse nuk ka qenë synimi i këtij studimi, organizatat për mbrojtjen e LGBTI e kanë identifikuar prej kohësh diskriminimin, bullizmin dhe largimin e komunitetit LGBTI nga sistemi arsimor, si një nga arsyt kryesore të numrit të lartë të papunësisë.

**30 përqind e komunitetit LGBTI** e ka përballuar këtë krizë falë mbështetjes së familjes, **por vetëm 1.7 përqind e tyre** e kanë tejkaluar krizën falë mbështetjes nga shteti, pavarësisht se pagën e luftës e kanë përfituar **22 përqind e tyre.**

Nga ana tjetër, **60 përqind e LGBTI thonë se ia kanë dalë mbanë vetë, një shifër inkurajuese që vërteton nivelin e lartë të reziliencës (aftësisë për t'u përshtatur) mes komunitetit LGBTI.**

**Fokus grupet e zhvilluara me anëtarë të komunitet theksuan dhe rëndësinë e mbështetjes psikologjike dhe ekonomike ndaj njëri tjetrit duke e kthyer solidaritetin mes tyre në një faktor kyç për përballimin e pandemisë.**

Këshillimi psikologjik dhe paketat ushqimore kanë qenë nevojat elementare të komunitetit LGBTI gjatë kësaj kohe të pandemisë, fakt ky që i jep këtij realiteti dimensionet e një krize për ekzistencë.

Komuniteti transgjinnor në Shqipëri e ka shumë të vështirë të punësohet, pothuajse të pamundur, fakt ky që konfirmon edhe njëherë, se për fat të keq, edhe brenda vetë komunitetit LGBTI ka një

hierarki të marxhinalizimit, ku komuniteti transgjnor, që njëherazi sfidon në mënyrë më kritike normat dhe stereotipet gjinore të shoqërisë shqiptare, mbetet më i diskriminuari.

Përfshirja në punën e seksit është parë si mënyra e vetme për të mbijetuar nga një pjesë e komunitetit transgjnor. Mirëpo gjatë periudhës së pandemisë ata e kanë pasur të pamundur të punojnë si punëtore seksi dhe si rrjedhojë kanë humbur të ardhurat, e domosdoshme për të përmbushur nevojat bazike si ushqimi, strehimi, medikamentet.

Edhe përsa i përket strehimit situata duket tejet e vështirë.

**Rezulton se 1 në 4 persona LGBTI (ose 25 përqind e tyre) nuk ia del dot të sigurojë strehimin.**

Kjo i detyron ata të kthehen pranë familjes së origjinës, një fenomen ky i ngjashëm në shumë vende të botës, fenomen që sociologët e kanë quajtur si “efekti i brezit boomerang” (boomerang generation).

Kthimi në familje në rastet kur familja ka qenë në dijeni të orientimit seksual të fëmijëve të tyre, është shoqëruar me konflikte, dhunë psikologjike dhe fizike.

Shqetësuese duket shifra e sëmundjeve kronike. Pavarësisht moshës së re (grafikët më poshtë) **rreth 11.5 përqind e LGBTI që morën pjesë në këtë studim, raportojnë se vuajnë nga sëmundje kronike.**


Nisur nga kjo situatë e vështirë social-ekonomike Aleanca LGBTI dhe Streha LGBTI ndërmorën masa të menjëhershme për t’i ardhur në ndihmë personave LGBTI që u goditën më së shumti nga pasojat e pandemisë së Covid-19. Nga muaji Mars deri në muajin Shator Aleanca dhe Streha kanë mbështetur me **624 paketa ushqimore rreth 117 persona të komunitetit LGBTI.**

Rreth **16 anëtarë të komunitetit LGBTI u strehuan në shërbimin e Strehës LGBTI**, gjatë periudhës Maj-Gusht (**824** netë qëndrimi). Aleanca dhe Streha kanë **mbështetur përmes rimbursimit të qirasë 28 anëtarë të komunitetit LGBTI (52 qira).**


Një focus i veçantë i është kushtuar shëndetit të personave më vulnerabël, ndaj Aleanca LGBTI dhe Streha LGBTI kanë mbështetur **me medikamente 25 anëtarë të komunitetit LGBTI**, dhe **23 anëtarë të komunitetit kanë marrë shërbime në qendrat shëndetësore përmes ndërmjetësisimit të organizatave.** Gjzatë kësaj periudhe pranë Aleancës LGBTI janë testuar për sëmundje seksualisht të **transmetueshme 342 persona, dhe kanë marrë këshillim rreth SST-ve 473 persona.**

### **Analizimi i të dhënave të pyetësorit**

Nga **228** të anketuar: 21.9% identifikohen si djem/burra gej, 13.6% identifikohen si vajza/gra biseksuale, 10.1% vajza/gra lezbike, 35.1% identifikohen si djem/burra biseksual, 7.9% identifikohen si interseks, 5.4% identifikohen si vajza/gra transgjnore, 3,1% djalë/burrë transgjnor dhe pjesa tjetër identifikohen si questioning/queer. (Grafiku 1).



Grupmosha e personave që i janë përgjigjur pyetësorit është: 7.9% grupmosha 14-17 vjeç; 33.8% grupmosha 18-25 vjeç; 37.3% grupmosha 26-35 vjeç; 16.7% grupmosha 36-45 vjeç dhe 4.7% grupmosha mbi 46 vjeç; (Grafiku 2).



Analiza e të dhënave sasiore dhe cilësore është ndarë në disa fusha kryesore si:

1. Punësimi
2. Strehimi
3. Shëndeti
4. Mirëqënia psikologjike
5. Diskriminimi

## 1. Punësimi

*“Per mua ka qënë shumë e veshtirë dhe është ende shumë e vështirë. Më ka ndihmuar vetëm njëherë njësia 4, por çfare mund të bëj unë në këto kushte kur jam pa përkrahje, pa mbështetje, pa shtëpi dhe pa të ardhura. Unë marr bonus nga bashkia 7000 lek, po ku gjen sot shtëpi me 7000 lek qeraja në muaj? Ndaj jam detyruar dhe kam shkuar nëpër kazanë të mbledh kanaçe e të paguaj qiranë”. Grua lesbike.*

*“Në fillim nuk punoja se kisha shumë frikë, por më pas kisha probleme. Nuk kisha lekë të paguaja qeranë, ndaj u riktheva në punë e që prej asaj dite nuk e kam lënë punën se nuk kisha kushte ekonomike. Më interesonte leku dhe nuk mendoja dot psikologjikisht që mund të infektohesha nga koronavirusi”, Vajzë transgjimore.*

*“Gjendja ekonomike ka qënë shumë e vështirë, duhet të sajohesha edhe për të ngrënë”. Vajzë transgjimore.*

Si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë së Covid-19, një numër i madh i personave të komunitetit kanë humbur vendin e punës, kanë punuar pa të drejtë page dhe si rrjedhojë kanë pasur ulje të konsiderueshme të të ardhurave. Gati ½ e personave të anketuar kanë vuajtur këto pasoja, nga të cilët komuniteti transgjimor është akoma më shumë i disavantazhuar. Komuniteti transgjimor në Shqipëri e ka shumë të vështirë të punësohet, pothuajse të pamundur sidomos në kushtet e vështira social-ekonomike të krijuara nga pandemia. Pamundësia e punësimit lidhet direkt me paragjykimin dhe diskriminimin e fortë që ekziston ndaj këtij komuniteti. Përfshirja në punën e seksit është parë si mënyra e vetme për të mbijetuar nga komuniteti transgjimor. Gjatë periudhës së pandemisë një pjesë e tyre e kanë pasur të pamundur të punojnë si punëtoreshë seksuale dhe si rrjedhojë kanë humbur të ardhurat, për të përmbushur nevojat bazike si ushqimi, strehimi, medikamentet. Paketat ushqimore të shpërndara nga Aleanca LGBTI dhe Streha LGBTI dhe mbështetja përmes rimbursimit të qirasë kanë qënë të vetmet burime mbështetje për shumë nga personat e komunitetit LGBTI.


Pyetjes se si ia kanë dalë për të plotësuar nevojat bazë të jetesës (ushqim, strehim, ilaçe) gjatë periudhës së Covid-19, **60.1%** e të anketuarve të komunitetit LGBTI i janë përgjigjur se ia kanë dal mbanë vetë dhe **30.7%** shprehen se i ka ndihmuar familja. Rreth **6%** e tyre shprehen se kanë marrë ndihmë nga organizatat dhe vetëm 4 prej 228 të anketuarve shprehen se kanë marrë ndihmë nga shteti.

Nevojat bazë për ushqim, ilaçe, rroba dhe strehim janë më të rëndësishmet siç dhe vlerësuan të anketuarit LGBTI, por pamundësia e **1/4** së tyre për të përmbushur këto nevojat themelore të jetesës pa ndihmën e familjarëve është jashtëzakonisht shqetësuese. Personat LGBTI kanë nevojë urgjente për një formë mbështetje financiare apo materiale nga shteti, pasi kanë humbur punën, strehimin dhe janë në rrezik. Nga studimi vihet re që kategoritë që rrezikohen më shumë nga pasojat e pandemisë janë komuniteti i grave transgjinore **5,4 %** dhe vajzave dhe grave lesbike dhe biseksuale **23.7%**. Këto kategori po përballen me shumë vështirësi në punësim, ndërsa rreziku i papunësisë dhe varfërisë rritet akoma më shumë për shkak të orientimit të tyre seksual apo identitetit të tyre gjinor.


*“Cdo klient mund të jetë me Covid dhe mund të infektosh. Jam mbrojtur me maskë dhe përdor gjithmonë dezinfektuesin”. Vajzë transgjinore/Punonjëse seksi*

*“Ne këtë punë e bëjmë nga halli, ne nuk marrim as pagë lufte e asgjë”. Vajzë transgjinore/Punonjëse seksi*


Nevojat kryesore të komunitetit LGBTI të identifikuar nga përgjigjet e pyetësorit janë; këshillimi psikologjik, konkretisht **25.9%** e të anketuarve; ndërkohë **15.8%** prej tyre kanë nevojë për ndërmjetësim në punësim; **14.9%** për paketa ushqimore; **10.1%** për kurse profesionale; **6.1%** për ndihmë mjekësore; **4.4%** prej tyre për ndihmë ligjore.



Përgjigjet e pyetësorit në lidhje me punësimin janë alarmuese. Të pyetur nëse janë të punësuar aktualisht, të anketuarit shprehen se **51.8%** janë të punësuar, kurse **46.5%** janë të papunë. Vetëm 4 prej të anketuarve janë shprehur se kanë përfituar ndihmë nga shteti, gjë që tregon tregon se ndihmat që shteti ka ofruar nuk e kanë arritur komunitetin LGBTI.




Të pyetur nëse kanë humbur vendin e punës për shkak të pandemisë: **60.5%** shprehen se nuk e kanë humbur vendin e punës, **20.6%** shprehen se kanë humbur vendin e punës për shkak të pandemisë dhe **18.4%** shprehen se kanë qënë të papunë edhe para krizës.





---

**43.9%** e të anketuarve punojnë në punë formale, **29.4%** janë të vetëpunësuar, **12.3%** punojnë në punë informale dhe pjesa tjetër janë të papunë.



Edhe pse shteti shqiptar ndërmoi disa politika për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve gjatë periudhës së pandemisë nga përgjigjet e pyetësorit vërejmë që komuniteti LGBTI nuk ka përfituar sa duhet prej tyre. Si rrjedhojë **73.2%** e të anketuarve shprehen se nuk kanë përfituar asnjë ndihmë nga shteti. Vetëm **22.4%** shprehen se kanë përfituar pagën e luftës, pra veç gjysma e personave të punësuar në punë formale.



Pas përfundimit të pandemisë dhe kthimit gradual në jetën e përditshme, një numër i madh i të papunëve në Shqipëri do të përpiqen të gjejnë vendin e tyre në tregun e punës. Duke njohur kontekstin shqiptar stigmatizues dhe diskriminues por dhe duke u bazuar në të dhënat e pyetësorit në lidhje me punësimin, mundësitë e punësimit dhe strehimit do të mbeten problematike sidomos për grupet më vulnerabël të komunitetit LGBTI.



## 2. Strehimi

*“Kur u ktheva në shtëpi ka qënë situatë e ndërlikuar, se nuk flisnim dot në telefon me shokët e shoqet. E reduktuam komunikimin edhe pse kisha shumë nevojë” Vajzë lesbike.*

*“Kisha frikë nga babi se është fanatik dhe nuk dua që ta humbas familjen time”. Djalë gej.*


*“Familja nuk më mbështet ashtu siç me mbështeste nga ana ekonomike se nuk kanë më”. Djalë gej*

*“Kam humbur punën dhe më kanë mbajtur të shtëpisë. Shumë nga komuniteti që unë njoh kanë humbur vendin e punës dhe janë kthyer në vendlindje, por njoh edhe nga ata që kanë punuar online”. Djalë gej.*


*“Streha më ka ndihmuar me qeranë e shtëpisë, se nuk dija se si do ia bëja ndryshe”. Vajzë transgjimore*

Strehimi është një sfidë e përditshme për komunitetin LGBTI, sidomos për atë pjesë të komunitetit që ka bërë coming out/dalë hapur në familje dhe nuk pranohet prej tyre, ose për personat pamja e të cilëve nuk përputhet me normat gjinore, si personat transgjinor. Një pjesë e madhe e tyre i sigurojnë të ardhurat duke punuar në vende me paga minimale ose punë informale. Për shkak të pandemisë shumë prej tyre e humbën vendin e punës dhe si pasojë mbetën të pastrehë. Një pjesë tjetër e tyre u detyrua të kthehej pranë familjeve, dhe të tjerë gjetën strehim dhe mbështetje tek miqtë ose të afërmit.


Duke ju referuar pyetësorit një shifër e konsiderushme rreth **25.4%** e të anketuarve shprehen se nuk mund të plotësojnë nevojat për strehim. Si rrjedhojë shumë prej tyre janë detyruar të kthehen pranë familjeve gjatë kësaj periudhave. Kthimi në familje në rastet kur familja ka qënë në dijeni të orientimit seksual të fëmijëve të tyre është shoqëruar me konflikte, dhunë psikologjike dhe fizike.



Të pyetur se me kë jetojnë aktualisht, **63.2%** shprehen se jetojnë me familjen, **18%** jetojnë vetëm dhe **12.7%** jetojnë me partnerin.



Shpenzimet për qiranë: **62.7%** e të anketuarve shprehen se shtëpia në të cilën jetojnë është pronë e familjes, **dhe 31.1% shprehen se jetojnë me qira**. Pjesa tjetër shprehen se jetojnë në konvikte studentore ose shtëpi ditore.




#### 4. Shëndeti


*“Marrja e metadonit ka qënë shumë e veshtirë, se nuk kishim metadon dhe nuk i duroja dot dhimbjet” Grua lesbike.*

Aksesi në shëndetësi ka qënë gjithmonë problematik për komunitetin LGBTI për shkak të diskriminimit dhe stigmatizimit. Vështirësitë më të mëdhaja janë hasur kryesisht nga komuniteti transgjinnor i cili për shkak të mungesës së legjislacionit dhe ekspertizës profesionale e ka të pamundur të aksesojë terapinë hormonale në Shqipëri.

Sipas të dhënave të studimit **11.4%** e të anketuar janë shprehur se vuajnë nga sëmundje kronike.



Të pyetur nëse kanë pasur nevojë për medikamente gjatë periudhës së karantinës, **16.7%** kanë pasur nevojë për medikamente, konkretisht 38 prej të anketuarve.



**11.5%**, e personave të cilët kanë pasur nevojë për medikamente shprehen se kanë hasur vështirësi në sigurimin e medikamenteve në kohë. Arsyet përse nuk kanë arritur të sigurojnë medikamentet në kohë, kanë qenë:

- 1. Mungesa në treg e ilaçeve,**
- 2. Mungesa e transportit publik,**
- 3. Vështirësimi për të aksesuar shërbimet pranë ISHP-së.**

Vështirësia në aksesin e medikamenteve ka qenë problematike kryesisht për personat që jetojnë me Hiv/Aids. Gjatë periudhës mars-maj personat e komunitetit që jetojnë me HIV/Aids e kanë pasur të pamundur të udhëtonin drejt Tiranës për të marrë medikamentet si rrjedhojë e masave kufizuese. Një pjesë e madhe e tyre u detyruan të ndërpresin mjekimin dhe kanë kontaktuar vazhdimisht Aleancën LGBTI për të adresuar këtë problematikë. Kjo eksperiencë duhet të shërbejë si mësim për sistemin shëndetësor i cili është totalisht i papërgatitur në menaxhimin e situatave të tilla që mund të kenë pasoja të rënda në shëndetin e qytetarëve.

## 5. Mirëqënia psikologjike

*“Javën e tretë filuan problematikat ekonomike dhe situatë u bë shumë depressive” Vajzë lesbike.*


*“Kemi pasiguri për të ardhmen, çdo ndodhë në të ardhmen nëse mbyllemi prapë”. Djalë gej*

*“Java e 3-të dhe e 4-tërt ishte më e vështira. Përjetova burg, u mërzitua dhe 1 vakt në ditë haja nga mërzitja” Djalë gej.*

*“Jemi mbështetur shumë te njëri tjetri, te komuniteti. Flisnim gjatë gjithë kohës në whatsapp dhe grupe”. Vajzë transgjimore.*

*“Kam ndjerë mbështetje nga aktivitetet online që zhvilloheshin nga Aleanca por edhe organizatat e tjera jashtë dhe do doja që këto aktivitete të vazhdonin se na ndihmojnë nga ana psikologjike”, Vajzë lesbike.*

Një ndër shqetësimet më të mëdha që ka sjellë pandemia dhe izolimi fizik tek personat e komunitetit është vështirësia për t’u socializuar me shokët/miqtë që janë mbështetës. Përgjatë periudhës së karantinimit e vetmja formë komunikimi dhe ruajtjes së marrdhënieve për komunitetin, ka qënë përmes rrjeteve sociale dhe aplikacioneve të tjera të komunikimit. Gjatë kësaj periudhe **57.9%** e të anketuarve kanë shpenzuar më shumë kohë në rrjetet sociale. Shqetësime të tjera që personat e komunitetit raportojnë se kanë përjetuar janë: simptoma të ankthit duke përfshirë probleme me gjumin, shtim ose humbje oreksi si dhe shtim ose humbje të madhe në peshën trupore. **4.4%** kanë vizituar mjekun e familjes nga merakun se mos ishin sëmurë, **21.1%** kanë shtuar konsumin e cigares dhe alkoolit, **33.3%** shprehen se kanë pasur probleme me gjumin.



**38%** e të anketuarve që kanë marrë pjesë në studim kanë raportuar që kanë përjetuar simptoma të depresionit si pasojë e karantinimit dhe izolimit fizik. Personat e komunitetit LGBTI kanë përjetuar pasiguri lidhur me financat për shkak të papunësisë që ka ekzistuar edhe para pandemisë por **39%** e personave që kanë marrë pjesë në studim raportojnë se kanë përjetuar pasiguri lidhur me financat si pasojë e humbjes së stabilitetit ekonomik përgjatë karantinimit. **28.9%** prej tyre shprehen se kanë pasiguri lidhur me punën dhe shkollën dhe se çfarë do të ndodhë në të ardhmen lidhur më këto aspekte të rëndësishme të jetës së tyre. Një pjesë e mirë e personave të komunitetit janë detyruar të kthehen tek familjet e tyre gjatë pandemisë dhe kjo ka rritur edhe frikën nga ekspozimi i orientimit të tyre seksual/identitetin gjinor. **79** persona që

kanë qëndruar pranë familjes gjatë kësaj periudhe kanë raportuar frikën se mos identifikoheshin nga familja lidhur me orientimin/identitetin gjinor.


Edhe përpara pandemisë personat e komunitetit LGBTI kanë qënë të rrezikuar lidhur me depresionin, ankthin dhe sjelljet vetëdëmtuese deri tek vetëvrasja. Përgjatë karantinimit **20** persona raportojnë se kanë përjetuar atake të shpeshta paniku dhe **10.1%** prej tyre raportojnë se kanë pasur mendime të përsëritura rreth vdekjes.

Qëndrimi dhe jetesa me familjarët ka qënë e vështirë për personat e komunitetit të cilët nuk kanë dalë hapur tek pjestarët e familjes lidhur me orientimin seksual apo identitetin gjinor. Përgjatë pandemisë personat e komunitetit kanë qënë të detyruar të bashkëjetojnë në mjedise familjare që nuk janë mbështetëse dhe pranuese për ta. Mungesa e lirisë dhe mungesa e të qenit vetvetja në mjediset familjare, distancimi nga grupet shoqërore mbështetëse dhe pranuese ka rritur perceptimin e të ndjerit të pambështetur duke sjellë kështu edhe izolim emocional, përveçse atij fizik. Për personat që kanë jetuar me familjen gjatë karantinimit ka qënë thuajse e pamundur të marrin shërbimin psikologjik online apo përmes telefonit për shkak se nuk kishin një ambient ku mund të flisnin lirshëm rreth përjetimeve të tyre, edhe pse kishin nevojë për këtë shërbim. I vetmi shërbim për të kërkuar ndihmë që kanë përdorur ka qënë këshillimi në chat përmes platformës [www.soslgbt.al](http://www.soslgbt.al).

**72%** e personave që morën pjesë në studim kanë raportuar simptoma të ankthit gjatë periudhës së karantinimit duke përfshirë këtu frustrim, irritim, nervozitet, frika që diçka e keqe mund të ndodhë. **38%** raportojnë simptoma të depresionit duke përjetuar humbje të interesit, motivimit në jetën e përditshme, kujtime të padëshiruara, mendime rreth vdekjes dhe pashpresshmëri për të ardhmen.

Nga përjetimi i këtyre shqetësime përgjatë karantinimit personat e komuniteti LGBTI shprehen se kanë pasur vështirësi në funksionimin dhe në realizimin e veprimtarive të përditshme, përkujdesjen për gjërat në shtëpi si dhe vështirësi në marrdhëniet me njerëz të tjerë.

**8.3%** shprehen se e kanë pasur ekstremisht të vështirë të funksionojnë si më parë në përditshmëri, **13.6%** shprehen se ka qënë shumë e vështirë veprimtaria e përditshme po ashtu si përkujdesja për veten apo për shtëpinë dhe **53.1%** shprehen se ka qënë disi e vështirë.



## 6.Diskriminimi


*“Komuniteti ka të drejtë të ece në rrugë dhe në trotuar. Ne, komuniteti trans sa herë dalim na ndalon makina e policisë dhe na ndalon të ecim në rrugë”. Vajzë transgjimore.*

*“Do doja nga shteti që mos na hapnin probleme në rrugë. Kur ne dalim nga shtëpia na ndalojnë policët dhe sjellja e tyre varet nga polici. Ka policë që na sillen mirë, ka edhe nga ata që sillen në mënyrë të patolerushme, para 1 jave më ndodhi me një polic i cili erdhi pa maskë duke më bërë titur të ikja nga trotuari. Më ka ardhur pështyma e tij në trup. Shteti do që ne të veprojmë sipas rregullave, po shteti vetë pse nuk i zbaton rregullat dhe e lë policin pa maskë?”. Vajzë transgjimore.*

*“Policia në shumë raste nuk di të sillet me ne. Ka nga ata që shprehen : Jeni bërë të gjithë si Anxhela. Atë punë keni ju, të prisni damarët. Ik në rot same. Kjo sjellje është abuzive nga policia”. Vajzë transgjimore.*


Izolimi fizik, ndërprerja e rutinës së përditshme, rikthimi pranë familjeve homofobike/transfobike, mungesa e socializimit me shokë/shoqe apo partnerë, qëndrimi me i gjatë në rrjete sociale kanë rritur si pasojë edhe mundësinë që personat e komunitetit të jenë më të rrezikuar ndaj formave të ndryshme të dhunës apo diskriminimit. **30** prej të anketuarve shprehen se kanë përjetuar dhunë psikologjike dhe janë bulluar, **4** prej tyre janë dhunuar fizikisht;

5 prej tyre janë ngacmuar seksualisht, si dhe 1 prej tyre është braktisur dhe ka përjetuar mosinteresim nga familja.



Vëndet më të shpeshta ku diskriminimi dhe dhuna ka ndodhur raportohet se kanë qenë; rrjetet sociale, në rrugë, në lagje dhe në familje.

Ashtu siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, pjesa dërmuese e atyre që kanë përjetuar dhunë nuk e kanë raportuar rreth **74.8%**, ndërkohë që vetëm **9.9%** e kanë raportuar. Këto të dhëna tregojnë që raportimi vazhdon të mbetet një problematikë që duhet adresuar.



Siç identifikohet në fjalitë hyrëse të këtij seksioni një nga problematikat e hasura vazhdimisht nga komuniteti transgjnor është dhe përplasja e vazhdueshme me policinë. Duke qenë se komuniteti transgjnor është dhe pjesa më e dukshme e komunitetit LGBTI, përballjet e tij me diskriminimin e ushtruar jo vetëm nga qytetarë por dhe institucione është shumë herë më e lartë dhe sistematike. Është shumë e rëndësishme që të drejtat e komunitetit transgjnor për të jetuar hapur identitetin e tyre gjinor të respektohen sidomos nga përfaqësuesit e institucioneve si Policia e Shtetit të cilët duhet të garantojnë të drejtat dhe liritë e këtij komuniteti dhe jo të kthehen në kërcënim dhe shkelës të të drejtave të tyre.



## **Rekomandime**

1. Qeveria shqiptare duhet të sigurohet që të gjithë masat e emergjencës të miratuara gjatë pandemisë si edhe mbështetja socio - ekonomike e emergjencës dhe kompenimet të mos lenë pas askënd, por të merret parasyshë cënueshmëria e grupeve më vulnerabël si komuniteti LGBTI.
2. Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet mbështetjes së anëtarëve të komunitetit LGBTI që punojnë në punë informale dhe ambiente të pasigurta, të cilëve duhet ti sigurohet aksesimi në shërbimet sociale, kujdesi shëndetësor si dhe mbulimi i nevojave bazë.
3. Shteti duhet të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të lidhura me integritetin fizik, veçanërisht për atë pjesë të komunitetit LGBTI që është më e rrezikuar në situata krize.
4. Të gjitha iniciativat specifike në trajtimin e problemit të rritjes së dhunës në familje, duhet gjithashtu të përfshijnë rrezikun e lartë të personave LGBTI, dhe veçanërisht të rinjve të ekspozuar ndaj dhunës në familje. Në plan afatgjatë, duhet zgjeruar përkufizimi i dhunës në familje duke përfshirë specifikisht edhe dhunën e ushtruar nga anëtarët e familjes ndaj personave LGBTI. Kjo do të ndihmojë dhe sigurojë që masat parandaluese të jenë më gjithëpërfshirëse, duke mos lënë pas personat LGBTI që abuzohen emocionalisht dhe fizikisht nga familjet e tyre.
5. Shteti duhet të përshtasë procedurat e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe strehimit me qëllim që personat e komunitetit LGBTI të cilët, janë të papranuar nga familja për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, t'u garantohet plotësimi i nevojave bazë që lidhen me strehimin, shëndetin dhe ushqimin, pranë qytetit ku ata banojnë, sidomos gjatë periudhave kohore, që shpallen nga shteti "gjendje emergjente".